



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 51/19
Prishtinë, më 24.04.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Dardan Molliqaj, Arbërie Nagavci, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Beontic dhe Ali Lajçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Felix Rathje- Policy Officer-EU Office, Albana Gjokolli-EUSR, Dr. Annette M. Fath-Lihits- Këshilltare Politike/Koordinatorë Ekzekutive-EUSR.

Pjesëmarrës tjerë: Albulena Avdiu: Gazetare nga Ekonomia Sot, Pajtim Çuni - Gazetar nga Radio Kosova, Arbisa Shefkiu Gazetare nga BIRN/KALLXO, Vlora Selim – Gazetare nga Arbëresh.info, Përparim Kryeziu – Hulumtues në GLPS, Klarisa Nuredini – Praktikante nga KDI, Rinor Gecaj – Hulumtues në DYD, Daut Tishuki – Monitorues në SHVK, Melihate Pllana – Monitoruese në SHVK; Valmira Hoti nga RTV2, Erduan Zeqiri nga Kosovapress, Dea Pallaska - Zyrtare e Programit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Terre Des Hommes, Marije Vuksani nga Terres Des Hommes, Shpresë Sejdiu nga Grupi Parlamentar PSD.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli, Doruntina Pireva-Praktikante, Sofie Tahiri- Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari i Komisionit).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për projektligjin 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe amendamentet e Komisionit funksional dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Kryetari i Komisionit konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me datë 20, 28/1, 28/2 mars dhe 3 prill 2019, pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për projektligjin 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256

Kryetari i Komisionit: Siç jemi të informuar grupi punues i caktuar nga komisioni dhe i udhëhequr nga z. Naser Osmani ka përfunduar punën në shqyrtimin e projektligjit dhe ka proceduar në komision raportin me amendamente. Për më tepër ia kaloj fjalën Z. Osmani.

Naser Osmani: Grupi Punues ka mbajtur disa takime ku është analizuar dhe shqyrtuar në tërësi Projektligji. Po ashtu janë shqyrtuar të gjitha komentet dhe amendamentet e pranuar. Në të gjitha takimet kanë qenë të ftuar dhe kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe OSCE-së dhe shoqërisë civile. Ndërkaq, nuk i'u kanë përgjigjur ftesës përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit. Një takim i veçantë është mbajtur me përfaqësuesit e subjekteve politike parlamentare.

Sa i përket afateve të ankesave të subjekteve politike ndaj gjobave të shqiptuara nga KQZ janë harmonizuar me afatet e përcaktuara me Ligjin për kundërvajtje (ka qenë 5 ditë në e kemi propozuar 30 ditë në gjykatën e shkallës së parë dhe ka qenë 5 ditë në e kemi propozuar 8 ditë në gjykatën e shkallës së dytë).

Ndryshimet kryesore të propozuara nga Grupi Punues janë si në vijim:

- Autonomia dhe kompetencat e Zyrës për Certifikimin dhe Regjistrimin e Subjekteve Politike në çështjen e raportimit, auditimit dhe shqyrtimit të gjobave të partive politike është zëvendësuar me KQZ-në. Grupi Punues ka vlerësuar nuk mundet që një zyrë të jetë e pavarur në funksionin e vet, të mos i jap llogari fare organeve drejtuese të institucionit ku është e strukturuar. Pra nuk mund të jetë një organ i pavarur brenda një institucioni. Në këtë drejtim ashtu siç është propozuar me Projektligj në nuk kemi marrë ndonjë njoftim se një rregullim i ngjashëm ekziston në ndonjë shtet të BE-së. Për transferimin e kompetencave nga Zyra në KQZ ka pasur kërkesa dhe harmonizimi nga të gjitha subjektet politike parlamentare. Përndryshe, Zyra ka mbetur që të ushtrojë kompetencat operative në relacion me auditimin e subjekteve politike, raportimin financiar, publikimin e raporteve dhe do të ketë staf profesional dhe buxhet të mjaftueshëm.
- Në kemi zvogëluar gjobat për subjektet politike dhe personat e autorizuar të këtyre subjekteve, nga ajo që është propozuar me Projektligj. Qëllimi ka qenë që të mbrojmë partitë më të vogëla.
- Sa i përket auditimit të subjekteve politike, GP ka vlerësuar se propozimi për ndarjen prej 5% nga fondi për mbështetjen e partive politike është i lartë dhe ka propozuar që të formulohet paragrafi 11.1/C dhe të thuhet se KQZ-s i ndahet buxhet i mjaftueshëm në fazën e përgatitjes së buxhetit vjetor për auditimin e subjekteve politike.

Ndërsa, ajo që duhet të vendos Komisioni është nevoja për riformulimin e amendamentit 46 dhe 47 që kemi propozuar si Grup Punues, për shkak të një gabim teknik dhe ka bërë me transferimin e

kompetencave nga zyra në KQZ, dhe ndryshimi tjetër ka të bëjë me fuqizimin e zyrës si nën program i veçant në kuadër të buxhetit të KQZ-së.

Përveç nevojës për këto dy riformulime të amendamentit 46 dhe 47, unë do të propozojë që të fshihet paragrafi 1 që i referohet ndryshimit të nenit 9 të ligjit bazik. Po ashtu, Grupi Punues nuk ka marrë qëndrim lidhur me amendamentin 9, ku kemi dy propozime: nga deputeti Lufti Zharku dhe deputetët Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci që i referohen çështjes së njëjtë dhe amendamentin 73 të propozuar nga deputeti Dardan Molliqaj, për të cilat duhet të vendos Komisioni. Përndryshe, amendamentet tjera nëse nuk ka vërejtje propozojë të votohen si paketë.

Kryetari: Siç jeni informuar dje kemi pranuar disa komente nga Zyra së BE-së lidhur me amendamentet e propozuara nga grupi punues dhe janë tri çështje që kërkojnë vëmendjen tuaj: E para, ka të bëjë me vendimin e Kryeministrit në vitin 2018 në të cilin ka kërkuar opinionin e Komisionit të Venedikut të interpretojë projektligjin dhe qëllimi kryesorë ka qenë nevoja që të sigurohet pavarësi për Zyrën e regjistrimit dhe certifikimit të partive politike dhe të ketë pavarësi nga partitë politike. Komenti i dytë ka të bëjë me gjobat, dhe është rekomanduar që gjobat të mbesin siç kanë qenë të propozuar në Projektligj, pra mos të ulen siç ka propozuar grupi punues. Komenti i tretë, ka të bëjë mbetjen e formës së ndarjes së buxhetit për auditimin e subjekteve politike siç është propozuar në Projektligj. Pyeti anëtarët e komisionit se a konsiderohet e nevojshme që ky projektligj duhet të dërgohet në komisionin ad-hoc për reformën zgjedhore apo të vendoset të procedojmë tutje?

Unë ndaj mendimin me grupin punues se nuk mund të krijojmë institucione paralele brenda KQZ-së, por në anën tjetër duhet ruajtur pavarësia e Zyrës. Ndarja e kodit buxhetor është një hap para. Sa i përket dënimeve mund të mbetet siç ka qenë në Projektligj, pra le të mbesin dënimet më të larta sepse është në funksion të disiplinimit të partive politike, për mos shkeljes së rregullave. Poashtu, ndarja e buxhetit për auditim mund të mbetet siç ka qenë në projektligj.

Naser Osmani: Komisioni i Venedikut jep në parim opinion se a cenohet sovraniteti, a lejohet ligjërisht çështje që propozuar, pasta a garantohet transparenca, por nuk jep propozime në formë deskriptive, po ta kishte dhënë do i ishim referuar ndonjë shteti. Sa i përket dënimeve për mua është njëjtë sepse unë i përkas një partie të madhe dhe nuk e shoh si problem të paguaj dënime eventuale deri në 40.000 euro. Propozimet e Grupit Punues kanë qenë që të mbrohen partitë e vogëla. Sa i përket ndarjes së buxhetit për auditimin e subjekteve politike ne kemi propozuar që kjo ndarje të bëhet në baza të rregullta dhe në shumën e mjaftueshme që nevojitet dhe jo që të jetë e përcaktuar me ligj shuma fikse e buxhetit për auditim.

Dardan Molliqaj: Theksoi se përkundër dallimeve për disa çështje në grupin punues, Kryesuesi i grupit ka menaxhuar mirë takimet dhe si rezultat për shumicën e çështjeve nga amendamentet që janë propozuara kemi pasur pajtueshmëri. Ndërkaq, ashtu siç u tha nga z. Osmani, janë tri amendamente që grupi punues nuk ka pasur qëndrim dhe duhet vendos Komisioni. Është amendamenti i propozuar nga Lufti Zharku, nga Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci dhe një nga unë.

Sa i përket Zyrës besoj që ka një gabim nga Qeveria me projektligj sepse e kanë integruar në mënyrë jo shumë kuptimplote këtë organ brenda ligjit dhe kornizës ligjore të Kosovës. Mënyra siç është propozuar organizimi dhe kompetencat e Zyrës është në kundërshtim edhe me Kushtetutën, pra nëse duam të mbajmë ashtu siç është propozuar, ne duhet ta ndërrojmë mënyrën e organizimit dhe funksionit të KQZ-së. Nuk besojë se kemi nevojë, pasi që praktika ka treguar se ne nuk kemi pasur probleme sa i përket rolit dhe përgjegjësisë të KQZ-së në raport me certifikimin, financimin apo edhe auditimin të partive politike, kur është bërë më herët.

Sa i përket dënimeve janë dy qasje: e para, aplikimi i dënimeve të larta apo maksimale ndaj shkelësve të ligjit për veprën që kanë bërë dhe e dyta aplikimi i dënimit si shkalla e fundit më të cilën synohet vetëdijesohen njerëzit për mos përsëritjen e shkeljeve ligjore apo arritja e qëllimeve rehabilituese dhe

përmirësuese ndaj të dënuarve. Nuk ka kuptim që të aplikohet qasja e ndëshkimit maksimal në Kosovë. Nuk jam i mendimit për ti larguar dënimet por të punojmë me partitë politike për respektimin e ligjit. Sa i përket buxhetit shtesë pajtohem plotësisht me propozimin e grupit punues që kjo ndarje buxhetore të ndahet sipas nevojës dhe jo të jetë e përcaktuar me ligj. Se ka qenë auditimi pjesë e KQZ-së, çdo herë është bërë auditimi i partive politike. Problemet janë shfaqur kur auditimi ka kaluar në Kuvend. Reforma zgjedhore nuk ka lidhje me këtë ligj, detyrat e komisionit ad-hoc janë të specifikuar për cilat ligje duhet punuar.

Arbërie Nagavci: Meqenëse kam qenë pjesë e grupit punues, kemi pasur diskutime konstruktive, por nuk pa pasur pajtueshmëri të plotë për të gjitha çështjet e propozuara nga grupi punues. Personalisht në fund më atë që është propozuar nga grupi punues nuk jam pajtuar. Kjo edhe për faktin se unë dhe deputetja Haxhiu kemi paraqitur 8 amendamente dhe prej tyre amendamenti 5 dhe 6 që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit dhe funksionit të Zyrës, të cilat nuk kanë marrë përkrahjen e grupit punues. Me amendamentin 5 është propozuar që të krijohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollim të Subjekteve Politike dhe të përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga kryetari i Gjykatës Supreme. Meqenëse nga grupi është kërkuar kjo zyrë të jetë në kuadër të KQZ-së edhe nga ne është përkrahur me kusht që Zyra të jetë organ kolegjal. Ndërsa, mbështes propozimin që kjo çështje të kalojë tek Komisioni për Reformë Zgjedhore. Kjo edhe për faktin që opinionin e Komisionit të Venedikut për këtë projektligj, tani nuk mund të quhet relevant, sepse pas këtij opinionin janë propozuar ndryshime thelbësore në projektligj, të cilat nuk janë trajtuar në kohën kur Komisioni i Venedikut ka dhënë opinionin.

Blerim Kuçi: Theksoi nuk duhet të lidhet ky projektligj me punën e komisionit për reformën zgjedhore. Ligjet praktike të domosdoshme nuk mundën ti ndalin ligjet tjera edhe nëqoftëse ka përputhshmëri. Prandaj propozoj që të procedojmë tutje me këtë projektligj.

Safete Hadergjonaj: Grupi punues ka kryer një punë të mirë ngase zakonisht ligjet e tilla janë të vështira për trajtim dhe harmonizim të qëndrimeve. Po ashtu mendojë se ky Projektligj për financimin e subjekteve politike nuk ka nevojë të kalojë tek grupi punues për reformën zgjedhore sepse rregullon një çështje tjetër që nuk hynë në kuadër të reformës zgjedhore. Këto plotësime-ndryshime të propozuara nga grupi punues e bëjnë më të zbatueshëm ligjin. Nga sqarimet që u dhanë nga Kryesuesi i Grupit Punues, kjo Zyrë siç është propozuar me Projektligj nuk ekziston në asnjë vend tjetër, prandaj ndryshimet e propozuar nga grupi punues për këtë çështje duhet të merren parasysh. Sa i përket ndarjes së mjeteve për auditim, sepse në më herët kemi pasur problem me ndarjen e mjeteve buxhetor për auditimin e subjekteve politike, ndërsa tani me këtë projektligj kalon te KQZ-së dhe gjërat janë më të rregulluara dhe kjo i kontribuon transparencë në publikimin e raporteve financiare dhe në procesin e auditimit.

Mërgim Lushtaku: Falënderojë Kryesuesi e Grupit Punues për menaxhimin e takimeve dhe në përgjithësi kemi pasur pajtueshmëri në shumë çështje që kemi propozuar, ndërsa çështjet divergjente i kemi lënë të vendos komisioni. Në shumicën e pikave pajtohem me grupin punues, besoj që në tërësi janë marrë parasysh praktikatat dhe shembujt evropian në këtë drejtim. Kalimi i përgjegjësive për auditim nga Kuvendi në KQZ ka qenë një zgjidhje e mirë. Sa i përket ndarjes së buxhetit për auditim, nuk është e nevojshme që me ligj të përcaktohet një kuotë e caktuar sepse çështja rregullohet duke u bazuar dhe në kushtet e tregut. Ndërkaq ajo që duhet vendos Komisioni është çështja e bartjes së mjeteve në rast se disa deputetë krijojnë shkëputen nga partia dhe krijojnë një subjekt të ri. Praktikisht kemi pasur ndarje të deputetëve apo krijimit të grupit të ri parlamentar nga një subjekt i caktuar, por nuk ka pasur ndarje të buxhetit. Por me rëndësi është që të ketë legjitimitet ndarje dhe aspekti buxhetore.

Felix Rathje: Ne si Zyrë e BE-së kemi dorëzuar disa komentet që ndërlidhen me propozimet e grupit punues. Në komentet që kemi dërguar theksi ynë është bazuar në opinionin e Komisionit të Venedikut që

është kërkuar vitin e kaluar nga Zyra e Kryeministrit. Ky mendim i Komisionit të Venedikut dhe komentet tona të përpiluara, ka qenë që të bëhet forcimi i Zyrës brenda KQZ-së, e cila do të jetë në qendër të këtij projektligji dhe do sigurojë transparencën dhe implementimin e ligjit. Sipas Zyrës së BE-së, projektligji nuk është në kundërshtim me Kushtetutën. Një rast të ngjashëm të veprimit kemi pasur ish Zyrën e Komisionit Disiplinor me një organizim të tillë të pavarur brenda Këshillit Prokurorial. Vendimmarrja për shkeljen e ligjit duhet të bëhet e pavarur dhe e pandikuar nga përfaqësuesit e partive politike në KQZ. Në aspekt administrativ kjo Zyre është e mundur të jetë e pavarur me atë që të ketë linjën buxhetore të ndarë në kuadër të KQZ-së. Ne po ashtu mendojmë se ky projektligj mund të dërgohet për trajtim edhe në komisionin ad hoc për reformën zgjedhore.

Kryetari i Komisionit: Pyeti kush e cakton udhëheqësin e Zyrës?

Naser Osmani: Sqaroi se Drejtori i Zyrës zgjidhet me konkurs sipas ligjeve në fuqi për emërimin e pozitive të larta drejtuese dhe zgjidhet për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat. Paneli përbëhet nga Kryetari i KQZ-së dhe nga një përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Avokati i Popullit, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Kryetari i Komisionit: Dmth kemi një pavarësi të siguar nga kryetari/kryetarja e KQZ-së?

Naser Osmani: Përfaqësuesit e Zyrës, janë eksperta profesional dhe jopolitik që merren me këto çështje. Edhe pse i strukturuar brenda KQZ-së kompetencat i ka të mjaftueshme, si buxhetin e veçantë, procedura e veçantë në emërimin e drejtorit.

Dardan Molliqaj: Ajo që kemi bërë me grupin punues lidhur me Zyrën vetëm e kemi futur brenda ombrellës së KQZ-së ndërsa gjitha kompetencat tjera që nuk bien ndesh me të janë me ligj dhe në rregull. Nga e kaluara e funksionimit të KQZ-së dhe as parashikimet për të ardhmen nuk ka arsye që mund të ketë probleme funksionimi i kësaj zyre.

Naser Osmani: propozojë që të ndryshohet amendamenti 46 dhe 47 i propozuar nga Grupi Punues me tekstin si në vijim:

Amendamenti 46

Neni 3.2., paragrafi 11.1.B. i shtuar ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

11.1/B Zyra është nën programi i veçantë brenda buxhetit të KQZ-së. Zyrës i ndahet buxhet i mjaftueshëm për shpenzime të rregullta dhe operacionale lidhur me kompensimin e personelit.

Amendamenti 47

Neni 3.2., paragrafi 11.1.C. i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1.C. Përfshihet nga neni 11.1.B. i këtij ligji, KQZ-së i ndahet çdo vit buxhet shtesë për auditimin e financimit të partive politike.

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni me 8 vota Për, 1 votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, miratoi propozimin për ndryshimin e amendamentit 46 dhe 47 të grupit punues, sipas tekstit të propozuar nga Kryesuesi i Grupit, z. Naser Osmani. Po ashtu, Komisioni miratoi të gjitha amendamentet e propozuara dhe përkrahura nga Grupi Punues dhe ato që nuk i ka përkrahur Grupi Punues, nuk i përkrahu as komisioni. Për amendamentin 6 të propozuar nga deputetit Lufti Zharku, amendamentin 1 të propozuar nga deputetit Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci dhe amendamentin e propozuar nga deputeti Dardan Molliqaj, Komisioni do të vendos në vijim të mbledhjes.

Naser Osmani: propozojë që në nenin 2.6 të projektligjit, të fshihet paragrafi 1, dhe të mbetet teksti siç është në nenin 9.1 të ligjin bazik.

Dardan Molliqaj: Mendoj se duhet të mbetet ky paragrafi 1 i shtuar në nenin 9 të ligjit bazik. Aktualisht kemi pasur koalicionin PAN dhe LA, siç ndodh praktika, paratë i ndahen PDK-së si përfaqësues ose bartës i koalicionit dhe ajo i ndan për deputetët që ka AAK dhe NISMA. Me këtë nen, koalicionet e regjistruara si parazgjedhore, nëse pas zgjedhjeve ndahen në grupe parlamentare, paratë do ti shkojnë në mënyrë direkte secilit subjekt sepse është më efikase.

Kryetari i Komisionit: Pasi që hodhi në votim dy propozimet, konstatoi se:

Komisioni me 3 vota Për, 6 vota Kundër dhe Asnjë votë Abstenim, nuk miratojë propozimin e deputetit Naser Osmani që në nenin 2.6 të projektligjit, të fshihet paragrafi 1 i nenit 9 të shtuar të ligjit bazik.

Ndërkaq, Komisioni me 6 vota Për, 3 vota kundër dhe Asnjë votë Abstenim, miratojë propozimin e deputetit Dardan Molliqaj, që të mbetet paragrafi 1 i shtuar në nenin 9 të ligjit bazik, ashtu siç është propozuar me projektligj,

Arbërie Nagavci: Amendamenti që nuk ka pasur qëndrim grupi punues ka të bëjë me nenin 2 paragrafi 6.2, të cilin kërkojmë të fshihet në tërësi. Në asnjë vend nuk kemi hasur praktik që nëse largohen ndonjë deputet nga subjekti politik që është zgjedhur të mund të bartë edhe mjetet financiare. Kjo bie ndesh me nenin 9 i cili tregon se mjetet duhet të mbeten në subjektin politik dhe jo për deputetë apo grupe deputetësh. Kemi arsyet dhe argumentet që kemi përmendur për fshirjen e paragrafit 2.

Dardan Molliqaj: Amendamenti i deputetit Zharku dhe deputetëve Nagavcit e Haxhiut mund ti bëjmë në një votim bashkërisht, pasi që te dy propozimet janë të njëjta dhe kërkohet të fshihet paragrafi 2 i shtuar në nenin 9 të ligjit bazik. Ndërsa, amendamenti i propozuar nga unë tenton të bëjë sqarime për organet të cilat do ta ekzekutojnë ligjin. Amendamenti im që është dispozitë përfundimtare, merr parasysh grupet parlamentare që janë të krijuara në Kuvendin e Kosovës pas hyrjes në fuqi të ligjit. Unë kam cekur edhe më herët se ky ligj do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese e cila do të vlerësojë kushtetutshmërinë e tij. Nuk kemi nevojë të shqetësohemi përderisa nuk kemi vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni me 3 vota Për, 6 vota Kundër dhe Asnjë votë Abstenim, nuk përkrahu amendamentin 6 të propozuara nga deputetit Lufti Zharku dhe amendamentin 1 të propozuar nga deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci. Ndërkaq, Komisioni me 6 vota Për, 1 votë Kundër, dhe 2 vota Abstenim, përkrahu amendamentin e propozuar nga deputeti Dardan Molliqaj.

Kryetari i Komisionit konstatoi pas përfundimit të diskutimeve dhe votimit të propozim-amendamenteve, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, Komisioni Raportin me amendamentet për Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, e procedon për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-068 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe amendamentet e Komisionit funksional dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetari i Komisionit: është një ligj i rëndësishëm, ka një kosto shtesë financiare të vlerësuar prej 1.4 milionë euro për tri vitet në vazhdim. Por duke vlerësuar rëndësinë e ligjit dhe duke pasur parasysh

faktin se ky ligj pritet të hy në fuqi një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ne mund ta përkrahim me vlerësimin se përmban kosto të përballueshme buxhetore.

Pas sqarimeve, Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për Projektligjin nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku